



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:297390
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05770335

C.nr.3392/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. K. nga fshati Miresh, komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Muhamet Haliti, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, me vlerë të kontestit 659.00 euro, jashtë seancës, me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A. K. nga fshati Miresh, komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që t'ia kompensojë pagën e 13-të, për vitin 2020, në vlerën e shumës së pagës bazë prej 659.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 26.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e pagës së 13-të, në vlerë të kontestit prej 659.00 euro.

Në padi ka theksuar se i njëjti është në marrëdhënie pune te e paditura dhe realizon pagë në lartësi prej 659.00 euro. Bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, ka konsideruar se i takon realizimi i pagës së 13-të, për vitin 2020, ndërsa e paditura nuk ka kryer obligimin që i del nga KKS. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 659.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë, 21.00 euro, për taksë gjyqësore dhe nga 135.00 euro, për seancë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka qenë në fuqi deri më datë 11.06.2021, prandaj nuk prodhon më efekt juridik. Ka vlerësuar se kërkesëpadia është e parashkruar, pasi është paraqitur pasi kanë kaluar më tepër se 3 vite. Për më tepër, kompensimi i pagës së 13-të, ka shtuar se realizohet sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, ndërsa në rastin konkret QKMF nuk ka pasur planifikim buxhetor për pagesën e pagës së 13-të, andaj edhe një pagesë e tillë nuk është realizuar. Realizimi i pagës së 13-të nuk është i karakterit detyrues, por devolutiv, në bazë të mundësive buxhetore, për çka edhe nuk janë paraqitur këto mundësi. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar te e paditura (fakt i provuar nga kontrata në kohë të pacaktuar e lidhur mes paditësit dhe të paditurës, nr.04-88 e dt.03.02.2016) dhe paga bazë e tij është 659.00 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit nga BRK).

Në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, në nenin 17, paragrafi 2 është përcaktuar se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Zbatimi i KKS-së, aplikohet për periudhën 11.06.2018 – 10.06.2021, ndërsa mos realizimi i pagës së 13-të, justifikohet vetëm nëse punëdhënësi provon se në asnjë mënyrë nuk ka pasur mundësi buxhetore për të kompensuar këtë pagë. Pra, barrën e të provuarit për mundësitë buxhetore e bart punëdhënësi.

Ky interpretim është në harmoni edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.212/2023 të datës 09.10.2023.

Për të provuar mundësitë buxhetore të të paditurës, gjykata ka administruar provën: Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2020, i publikuar në Prishtinë, Qershor 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Sa i përket Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2020, të publikuar në Prishtinë, Qershor 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, në faqen 20,

pikën 3 shihet se është konstatuar se “në vitin 2020, Komuna e Gjilanit ka shpenzuar 93 % të buxhetit përfundimtar, ose 27,361.357 euro, me një ulje 1 % në krahasim me vitin 2019”. Në ekstraktin tabelar shihet se në vitin 2020 për kategorinë pagat dhe mëditjet, buxheti final ka qenë 15,929,937 euro, ndërsa shpenzimet kanë qenë 15,816,156 euro.

Nga kjo konstatohet se për 113,781 euro, nuk është shfrytëzuar buxheti final nga e paditura sa i përket kategorisë pagat dhe mëditjet.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, vlerësoi se raporti i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka fuqinë provuese të saktësisë së të dhënave në të, prandaj të njëjtës gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata vlerëson se në këtë rast e paditura e ka provuar se nuk ka pasur mundësi buxhetore për kompensimin e pagës së 13-të, për të punësuarit e saj, ndërsa meqë ky kompensim realizohet vetëm në bazë të mundësive buxhetore, gjykata e refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësit.

Faktin se e paditura nuk ka pasur mundësi buxhetore për këtë kompensim, gjykata e vërtetoi nga dokumentet e theksuara si më sipër, nga të cilat konstatoi se e paditura për vitin 2020 në kategorinë pagat dhe mëditjet sipas buxhetit final dhe atij të shpenzuar ka pasur suficit prej 113,781 euro.

Kjo shumë, gjykata vlerëson se nuk paraqet mundësi buxhetore të mjaftueshme për kompensimin e pagës së 13-të, pasi përbën një shumë që në asnjë mënyrë nuk arrin të kompensojë të gjithë të punësuarit e saj, me ç'rast provon se e paditura nuk ka mundësi buxhetore për këtë kompensim.

Thënë këtë, gjykata vlerëson se është justifikuar mos kompensimi i pagës së 13-të, në mungesë të mundësive buxhetore, pasi sipas bindjes së lirë së gjykatës nga faktet e paraqitura në padi dhe në përgjigje në padi, shqyrtimi dhe analizimi i raportit të auditimit, vlerësohet se suficiti prej 113,781 euro, nuk paraqet mundësi buxhetore mbi bazën e së cilës mund të kompensohet paga e 13-të, për të punësuarit e të paditurës.

Nga kjo arsye, gjykata vendosi të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se padia nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 26.12.2023, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht për pagën e 13-të, të vitit 2020.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, i njëjti nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Numri i lëndës: 2023:297390
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05770335

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.3392/23, datë 22.05.2024

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.